



Me rastin e Asamblesë së Shtatë të Gjyqtarëve të EULEX-it, të mbajtur në Prishtinë më 23 shtator 2009

Asambleja e përbërë nga Gjyqtarët: Maria Giuliana Civinini, Kryetare e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it; Guy Van Craen, Nënkyetar i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it; Gjyqtarët e EULEX-it: Angela Kaptein; Antoinette Lepeltier-Durel; Arkadiusz Sedek; Christine Lindemann-Proetel; Dragomir Yordanov; Eija-Liisa Helin; Ferdinando Buatier de Mongeot; Francesco Florit; Gerrit-Marc Sprenger; Gianfranco Gallo; Hajnalka Karpati; Harri Katara; Klaus Jung; Piero Leanza; Richard Winkelhofer; Torsten Koschinka; Vitor Pardal; Vladimir Kanev.

Merr VENDIM

Njëzëri, për aprovimin e këtij udhëzimi për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe për Gjykatat e Kosovës lidhur me qasjen në gjykata.

U D H Ë Z I M

Për:

- Këshillin Gjyqësor të Kosovës
- Kryetarët e Gjykatave të Qarkut dhe Komunale të Kosovës

Nga: Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, Komponenti i Drejtësisë i EULEX-it

Lënda: Këshillë për Gjykatat e Kosovës lidhur me qasjen në gjykata

Kryesia e Asamblesë së
Gjyqtarëve të EULEX-it

Gjykata Supreme e Kosovës

Rruga Luan Haradinaj
Avenjja e Policisë

Fahu Postar: 268, 10000
Prishtinë, Kosovë
Tel: +381(0)38 222 0104111
www.eulex-kosovo.eu



1. Përmbledhje Ekzekutive

Siç parashihet me nenin 3 të Veprimit të përbashkët të Këshillit të Bashkimit Evropian të datës 4 shkurt 2008 mbi Misionin e Bashkimit Evropian të Sundimit të Ligjit në Kosovë, ky mision ka për detyrë që të *“(a) monitorojë, udhëzojë dhe këshillojë institucionet kompetente të Kosovës në të gjitha fushat lidhur me sundimin e ligjit në tërësi (përfshirë shërbimin doganor), duke mbajtur disa përgjegjësi të caktuara ekzekutive”*.

Neni 2.4 i Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë i datës 13 mars 2008 (Ligji nr. 03/L-053) përcakton se: *“përveç ushtrimit të funksioneve gjyqësore në përputhje me dispozitat e neneve 3, 4 dhe 5 të këtij ligji, gjyqtarët e EULEX-it do të monitorojnë, udhëzojnë dhe këshillojnë gjyqtarët kosovarë për sa i përket parimit të pavarësisë së gjyqësorit dhe në përputhje me modalitetet e përcaktuara me anë të këtij ligji nga ana e EULEX-it në KOSOVE”*.

Në veçanti, këshillimi përbëhet nga qëndrimet formale dhe zyrtare të marra në mënyrë të përbashkët nga ana e gjyqtarëve të EULEX-it në Asamblesë e gjyqtarëve të EULEX-it dhe i drejtohen organeve vendore gjyqësore, legislative apo qeveritare për të stimuluar veprimet e tyre në fushat përkatëse të përgjegjësisë së tyre. Me fjalë të tjera, këshillimi ka për qëllim sigurimin e këshillave profesionale për organet kompetente (Ministrinë e Drejtësisë, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Kryetarët e Gjykatave, Gjykatën Supreme, Parlamentin, Fakultetin Juridik) rreth çdo çështjeje që del nga përvoja e monitorimit dhe udhëzimit. Këshillimi i siguron palës së interesuar kosovare informata të nevojshme për ndërhyrje në ato fusha të sistemit të drejtësisë të cilat kanë nevojë për përmirësime të përgjithshme dhe strukturale në tërë sistemin gjyqësor, të cilat nuk mund të zbatohen me anë të aktivitetit monitorues vetëm të gjyqtarëve të EULEX-it.

Ky udhëzim për Kryetarët e gjykatave të Kosovës mbi qasjen në gjykata paraqet rezultatin e aktiviteteve të monitorimit dhe të udhëzimit të Gjyqtarëve të EULEX-it, duke u këshilluar ngushtë me kolegët e tyre kosovarë. Këto aktivitete kanë vënë në pah ekzistimin e disa problemeve lidhur me qasjen në gjykata për shkak të pauzave gjatë ditës dhe pushimit vjetor të punonjësve. Praktikrat e tanishme nuk janë në përputhje me praktikrat më të mira evropiane pasi që pengon qasjen e publikut në drejtësi. Këto gjetje dëshmojnë nevojën urgjente për ndryshimin e praktikës së tanishme me qëllim të ofrimit të qasjes më të sigurt dhe më të parashikueshme të publikut në gjykatat e tyre. Një gjë e

Kryesia e Asamblesë së
Gjyqtarëve të EULEX-it

Gjykata Supreme e Kosovës

Rruga Luan Haradinaj
Avenjja e Policisë

Fahu Postar: 268, 10000
Prishtinë, Kosovë
Tel: +381(0)38 222 0104111
www.eulex-kosovo.eu



tillë do të kishte gjithashtu efekte pozitive edhe në efikasitetin e punës së gjykatës.

2. Hyrje

Qasja në drejtësi është një nga parimet më të rëndësishme të një sistemi të drejtësisë duke u mbështetur në sundimin e ligjit. Ky parim i mbrojtur me nenin 6 të Konventës evropiane për të drejtat e njeriut, zbatohet në mënyra të ndryshme; njëra nga to është qasja në dokumente dhe shërbime të gjykatës së drejtësisë. Të gjithë personat në Kosovë duhet të kenë mundësinë që të arrijnë në një gjykatë brenda një kohe të arsyeshme dhe të parashikueshme gjatë orarit të saj të punës. Kjo gjë vlen jo vetëm për zyrën e pranimit të gjykatës por edhe për të gjitha zyrat publike duke përfshirë zyrat e shkrimores, zyrat e arkivit dhe zyrat për përmbarim. Nëse këto zyra nuk kanë orar të qartë dhe të qëndrueshëm të punës, atëherë publiku nuk do të ketë nivel të pranueshëm të qasjes në drejtësi.

3. Gjendja e tanishme

Gjatë kryerjes së funksioneve të MUK-ut dhe gjatë bashkëveprimit me punonjësit e gjykatave kosovare, lidhur me orarin e punës janë identifikuar këto probleme:

- Në praktikë, shumica e gjykatave i mbyllin shkrimoret e tyre, zyrat e arkivit dhe zyrat për përmbarim gjatë pauzës së drekës. Për më tepër, pauza e drekës nuk është e njëjtë në të gjitha gjykatat; ajo shfrytëzohet në intervale të ndryshme (për shembull 9.00-10.00, 10.00-11.00 ose 12.00-13.00). Përderisa këto zyra janë të mbyllura, njerëzit presin jashtë derisa të njëjtat të hapen përsëri. Një gjë e tillë është veçanërisht e papërshtatshme dhe zhgënjyese sidomos për njerëzit që vijnë nga fshatrat, të cilët mbase kanë bërë udhë të gjatë për të arritur në gjykatë dhe iu duhet që të kthehen në shtëpitë e tyre brenda një kohe të arsyeshme.
- Gjatë periudhës së pushimeve, gjendja lidhur me qasjen në gjykata përkeqësohet edhe më tepër. Kjo për shkak se ndodh që vetëm një punonjës të jetë përgjegjës për tërë zyrën, kështu që zyra thjesht mbyllet kur punonjësi merr pauzën ose është në pushim, sepse nuk ka punonjës tjetër të trajnuar ose të autorizuar për ta udhëhequr zyrën. Kështu, zyra mbetet e mbyllur me javë të tëra. Kjo natyrisht është e papranueshme për publikun, si dhe për institucionet e tjera, të cilat mund të kenë nevojë për qasje në dokumente dhe në shërbime

Kryesia e Asamblesë së
Gjyqtarëve të EULEX-it

Gjykata Supreme e Kosovës

Rruga Luan Haradinaj
Avenjja e Policisë

Fahu Postar: 268, 10000
Prishtinë, Kosovë

Tel: +381(0)38 222 0104111
www.eulex-kosovo.eu



pikërisht të asaj zyre. Për më tepër, përmes aktiviteteve të MUK-ut të gjyqtarëve të EULEX-it, është vërejtur se kjo gjë shkakton vështirësi në përmbushjen e detyrave të gjykatave. Në rastin e zyrës për përbarim, një zyrtar përbarimor thotë se ka pasur shumë raste kur debitorët jetonin jashtë vendit dhe ktheheshin në Kosovë vetëm gjatë pushimeve të verës, dhe kur ktheheshin në Kosovë punonjësi ishte në pushim dhe pasi që askush nuk po e zëvendësonte, asnjë përbarim nuk mund të kryhej ndaj këtyre debitorëve. Në këtë mënyrë, ky problem po ashtu pengon edhe marrjen me rastet e përbarimit dhe nga ana tjetër shton numrin e lëndëve të pazgjidhura të gjykatave.

Gjykatat janë për t'u ofruar shërbime publike qytetarëve, prandaj ato duhet të jenë institucione në të cilat qytetarët kanë qasje të lehtë. Në lëndët e lartpërmendura metodat e punës së gjykatave janë në kundërshtim të qartë me parimin e qasjes së lirë në gjykata. Për më tepër, problemet e cekura më lart në shumicën e rasteve mund të zgjidhen përmes masave relativisht të thjeshta. Sa i përket çështjes së pauzës së drekës, gjykatat duhet të organizojnë pauza individuale të drekës të punëtorëve të saj ashtu që të sigurohet se zyrat për të cilat publiku ka nevojë për qasje të vazhdueshme, si shkrimorja dhe zyra për përbarim, të mos jenë asnjëherë të mbyllura gjatë orarit të punës 08:00 – 16:00. Në po të njëjtën mënyrë, punonjësit e gjykatave duhet ta organizojnë pushimin e tyre vjetor në atë mënyrë që mos ta lënë asnjëherë zyrën publike pa punëtor. Kjo natyrisht mund të duket e vështirë pasi që në shumicën e rasteve vetëm një person është përgjegjës për tërë zyrën. Sidoqoftë, përmes masave organizative si trajnimi i punonjësve dhe bashkëpunimi në mes tyre, do të duhej të ishte e mundur që gati në shumicën e rasteve të gjendet zëvendësimi i përkohshëm për personat të cilët gjenden në pushim. Punëtori i gjykatës i cili është duke shkuar në pushim duhet ta udhëzojë punëtorin tjetër për përmbushjen e detyrave të tij apo saj gjatë periudhës së pushimit. Kjo është praktikë e zakonshme në shumë sisteme të gjykatave dhe të institucioneve të tjera të Evropës dhe nuk ka asnjë arsye që ky sistem mos të zbatohet edhe në Kosovë. Në raste të rralla kur kjo zgjidhje nuk është e mundur, gjykata do të duhet të punësonte punëtor të ri.

4. Rekomandimet

Në frymën e konkluzioneve të mësipërme, këto rekomandime i janë paraqitur gjykatave të Kosovës:

- Gjatë orarit të rregullt të punës të gjykatave 08:00 – 16:00, publiku duhet të ketë qasje në të gjitha zyrat përkatëse të gjykatës, si në shkrimore ashtu dhe në zyrën për përbarim. Punëtorët e gjykatës

Kryesia e Asamblesë së
Gjyqtarëve të EULEX-it

Gjykata Supreme e Kosovës

Rruga Luan Haradinaj
Avenjja e Policisë

Fahu Postar: 268, 10000
Prishtinë, Kosovë
Tel: +381(0)38 222 0104111
www.eulex-kosovo.eu



duhet të udhëzohen që t'i organizojnë pauzat e tyre të drekës në atë mënyrë që një gjë e tillë të ishte e mundur.

- Periudhat e pushimeve verore të punonjësve duhet të organizohen në atë mënyrë që të gjitha zyrat përkatëse të jenë të hapura gjatë gjithë kohës. Në rastet kur është vetëm një person i caktuar në një zyrë, duhet të organizohet trajnimi i punonjësve që të krijohen mundësi për zëvendësimin e këtij punëtori kur ai apo ajo shkon në pushim.

5. Konkluzionet

Përmirësimi i qasjes në gjykata dhe me këtë edhe i qasjes në drejtësi është pjesë e rëndësishme e zhvillimit të gjykatave të Kosovës. Me implementimin e rekomandimeve të lartpërmendura publiku do të kishte qasje më të mirë në gjykata dhe po ashtu do të ngitej efikasiteti i punës së gjykatave.

Për arsyet e lartpërmendura, Asambleja e gjyqtarëve të EULEX-it

UDHËZON

Kryetarët e Gjykatave të Kosovës që të zbatojnë një rutinë të atillë të punës në gjykatat e tyre përkatëse, e cila do të sigurojë mbetjen hapur të të gjitha zyrave publike të gjykatës gjatë tërë orarit të rregullt të punës (ditëve të punës 08:00 – 16:00) si dhe gjatë tërë periudhës së pushimeve verore.

Maria Giuliana Civinini

Kryetare e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it

Kryesia e Asamblesë së
Gjyqtarëve të EULEX-it

Gjykata Supreme e Kosovës

Rruga Luan Haradinaj
Avenija e Policisë

Fahu Postar: 268, 10000
Prishtinë, Kosovë
Tel: +381(0)38 222 0104111
www.eulex-kosovo.eu